



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-108134/22 dt. 17.05.2022, të pronarëve Muharrem dhe Ismet Bullatovci nga Prishtina me investitor “Alko Group” SH.A. nga Prishtina rr. “Bedri Berisha, Mati 1, dhe Noku-O-S-2008 N.N.SH. nga Tirana, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesave shumë banesore me afarizëm “C1” dhe “C2”, me etazhitet 2B+P+7 dhe 2B+P+8+Nk të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A-11” të tërësisë hapsinore “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, konkretisht në parcelën nr. 01634-0, ZK Matiçan, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datën 11.10.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Muharrem dhe Ismet Bullatovci me investitor “Alko Group” SH.A. nga Prishtina dhe Noku-O-S-2008 N.N.SH. nga Tirana, sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-108134/22 dt. 17.05.2022, për përdorimin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm “C1” dhe “C2”, me etazhitet 2B+P+7 dhe 2B+P+8+Nk, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A-11” të tërësisë hapsinore “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, konkretisht në parcelën nr. 01634-0, ZK Matiçan, sipas Vendimit 05Nr.351/02-120063/19 dt. 22.10.2019 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave.

II. Ndërtesat, mund të përdoren, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr.351/02-120063/19 dt. 22.10.2019, dokumentacionit ndërtimor dhe Njoftimit të Inspektimit Final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit të Komunës së Prishtinës Sektori i Ndërtimit.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Muharrem dhe Ismet Bullatovci me investitor “Alko Group” SH.A. nga Prishtina dhe Noku-O-S-2008 N.N.SH. nga Tirana, sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-108134/22 dt. 17.05.2022, kanë kërkuar nga kjo drejtori, lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+7 dhe 2B+P+8+Nk, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 391/02-278080/21 dt. 23.12.2021 ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit:

- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f.
- Vendimin nr. 05Nr.351/02-120063/19 dt. 22.10.2019 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm 2B+P+7 dhe 2B+P+8+Nk në parcelën nr. 01634-0, ZK Matiçan.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin me nr. 05Nr.351/02-120063/19 dt. 26.08.2019, mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Vendimin nr. 05Nr.351/05-38891/19 dt. 18.04.2019 për miratim të ndryshimit dhe plotësimit të konkluzionit-zgjidhjes urbane.

Berisha” dhe numrat e hyrjes 77, 81, 83, 85, 87, 89, 91.

- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Mazllum Ballata IDA., Përparim Ali Hoxha IDA mbikëqyrës për arkitekturë, Rexhep Saliu IDN. mbikëqyrës për strukturë, Blerim Dyla IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Florim Bajrami IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Nysret Ismajli IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike, Arban Shala dhe Agim Lajçi mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Roland Merxha me nr. të licencës 167.
- Protokollin e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,
- Certifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesës i prezentuar nga Drejtoria e Inspektionit Sektori i Ndërtimit, me referencë 09 Nr. 391/02-278080/21 dt. 23.12.2021, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 351/04-108134/22 dt. 17.05.2022, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05Nr.351/02-120063/19 dt. 22.10.2019. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumë banesore me afarizëm, mund të përdoren.

Në Njoftimin mbi inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në ndërtesë janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdojë procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27, janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesat shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+7 dhe 2B+P+8+Nk, mund të përdoren/shfrytëzohen, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këto ndërtesa.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuësve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/04-108134/22 DT. 11.10.2022**

Zyrtari:

Arbër Morina



U.D. Udhëheqëse e sektorit

Nazifë Krasniqi



Drejtori:

Arber Sadiki



Faqe 2 prej 2